



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.501/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Sharr Beteiligungs GmbH” ShPK me NUI 810304808 me seli në rrugën Lagja e Punëtorëve p.nr. në Elez Han, i cili përfaqësohet në bazë të prokurës nga avokati Dastid Pallaska me seli në rrugën Ali Pashë Tepelena, Ivy Residence nr. 12 në Prishtinë, kundër debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” me seli në rrugën Dëshmorët e Kombit p.nr. në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, te ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles se Parë, KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles se Parë, KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.814/2022 të datës 13.12.2022 të përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023.

Përgjigje ne ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori, përmes se cilës ka propozuar që gjykata e shkallës se dytë ta refuzoj ankesën e debitorit si të pabazuar, dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Sharr Beteiligungs GmbH” ShPK, ka paraqitur propozim për përmbartim zyrën e përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që nga debitori “Administrata Tatimore e Kosovës” me të dhëna tjera si në hyrjen e këtij aktvendimi (këtu e tutje Debitorët) të realizoj kërkesën shumë prej 395,113.06€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% nga data 16.12.2014 deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim ia kishte bazuar në aktgjykimin A.nr. 2511/14 të datës 18.07.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, të cilin në origjinal ia kishte bashkëngjitur Propozimit (këtu e tutje Aktgjykimi). Kreditori së bashku me Propozimin, i kishte dorëzuar edhe kopjen e aktgjykimit AA.nr.869/2019 të datës 31.01.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; aktgjykimin ARJ.nr.29/2022 të datës 20.10.2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe kërkesën për përmbartim vullnetar me numër 07-06-888 të datës 03.03.2022 të Kreditorit për Debitorin Përmbartuesi më 13.12.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.814/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri). Debitori më 27.012.2022 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai kanë deklaruar se më 05.05.2022 ka bërë një raport të kontrollit, nëpërmjet të cilit i ka bërë ndryshimet e duhur përmes rekonstruktimit dhe rregullimit përfundimtar të shpenzimeve të interesit në pasqyrat e të ardhurave për TAK/2006-2008 në periudhën 03/2022 sipas pikës III të aktgjykimit. Sipas Debitorit, nga prerja e gjendjes në formë të kompensimit në raportin debi-kredi rezulton se tatimpaguesi të ketë detyrime tatimore ndaj tij. Prandaj, ai konsideron se e ka ekzekutuar aktgjykimin lëndor. Prapësimi ia ka bashkëngjitur disa njoftime për rivlerësim, raportin kontrollues të datës 05.05.2022 dhe disa dokumente tjera të tij në raport me Kreditorit lidhur me procedurën pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit lëndor, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi Prapësimin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Ai ka deklaruar se Prapësimi është i palejueshëm, pasi nuk bazohet në nenin 71 të LPP-së, si bazë ekskluzive për paraqitjen e prapësimi, siç përcakton neni 69 para. 5 i LPP-së. Më tutje ka sqaruar se sipas Prapësimi, Debitori nuk mund t'i zbatoj aktgjykimet përmes rivlerësimit të detyrimeve tatimore. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve

procedurale të shkaktuara në këtë gjykatë lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim përmes avokatit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023.me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrorit përmbarrimor P.nr.814/2022 të datës 13.12.2022 të përmbarruesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren.

Gjykata vlerësoj se Aktgjykimi është i formës së prerë dhe ka kaluar koha e përmbushjes vullnetare, pra është bërë i ekzekutueshëm, si dhe përmban të dhëna për palët, llojin dhe shumën e detyrimit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, rrjedhimisht i plotëson të gjitha kushtet për të qenë dokument përmbarrimor dhe për të lejuar përmbarrimin në bazë të tij.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkalles se Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin atakuar KPPP.nr.45/23 të datës 29.12.2023, me të cilin ka refuzuar prapësimin e debitorit nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë pasi që nuk ka arrit drejt gjetjes se një konstatimi te saktë nëse debitori ka zbatuar aktgjykimin e plotëfuqishëm duke pas parasysh se debitori pretendon se është i obliguar që menjëherë pas pranimit të aktgjykimit të hap rikontroll dhe përmes raportit të kontrollës të bëj ndryshimet e duhura përmes rekonstruktimit dhe rregullimit përfundimtar të shpenzimeve të interesit në pasqyrat e të ardhurave për TAK/2006-2008, në periudhën 03/22 sipas kushteve detyruese të vendosura në aktgjykim.

Ashtu qe me qellim te harmonizimit te shkresave ne lëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësoj nëse debitori ka zbatuar aktgjykimin A.nr. 2511/14 të datës 18.07.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës AA.nr.869/2019 të datës 31.01.2022, si dhe i ndryshuar me aktgjykimin ARJ.nr.29/2022 të datës 20.10.2022 të Gjykatë Supreme të Kosovës, sa i përket normës së kamatës 8% , andaj, me qellim te konstatimit real te detyrimeve te debitorit marrë për bazë edhe pretendimet e palëve ne procedure, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkalles se parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse*

vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata, arsye këto nga te cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të refuzuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e debitorit e pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë nëse është zbatuar aktgjykimi i lartcekur, eventualisht të hapë edhe seancë për ti vërtetuar pretendimet e palëve në këtë çështje përmbarimore, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.501/24, me datë 05.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami